



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 maj 2013
Nr. ref.: RK410/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI01/13

Parashtrues

Betim Ramadani

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit nga Prokurori i Shtetit,
KMLC. nr. 106/2012, të 23 tetorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Betim Ramadani (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi), të cilin e përfaqëson z. Shevqet Xhelili, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston njoftimin nga Prokurori i Shtetit, KMLC. nr. 106/2012, e 23 tetorit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 27 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se njoftimi i lartpërmendur ka cenuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 janar 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 janar 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emëroi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, si dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 27 shkurt 2013, kërkesa iu komunikua Prokurorit të Shtetit.
8. Më 15 prill 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues, si dhe gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi me gjyqtarin Enver Hasani, si anëtarë të Kolegjit shqyrtues.
9. Më 30 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në vitin 2009, parashtruesi i kërkesës bëri një marrëveshje me Xh. K., për të marrë me qira një lokal afarist për dhjetë vjet, gjë që edhe e bëri, si dhe, përveç kësaj, ai bëri edhe disa investime. Megjithatë, sa i përket këtij lokali, ka pasur një procedurë gjyqësore në vazhdim e sipër, përkitazi me konfirmimin e pronësisë mes Xh. K. dhe Z. Y.
11. Më 15 mars 2011, Gjykata Komunale në Gjiilan (Vendimi C. nr. 420/2005) gjeti që Xh. K. kishte tërhequr padinë e tij për konfirmim të pronësisë. Rrjedhimisht, Z. Y. parashtroi kërkesë për përmbarimin e këtij vendimi dhe largimin e parashtruesit nga lokali afarist që ai kishte marrë me qira nga Xh. K.
12. Parashtruesi pohon se, më 27 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Gjiilan (Vendimi E. nr. 2907/2011) lejoi përmbarimin e Vendimit të saj, C. nr. 420/2005, të 15 marsit 2011.
13. Ndërkohë, më 1 shkurt 2012, Z. Y. edhe një herë parashtroi kërkesë për përmbarimin e Vendimit C. nr. 420/2005, të 15 marsit 2011, si dhe kërkoi që parashtruesi të largohet nga lokali afarist.
14. Më 15 shkurt 2012, parashtruesi, si palë e tretë, parashtroi kundërshtim ndaj kërkesës për përmbarim. Gjykata Komunale në Gjiilan e hodhi poshtë kundërshtimin si të pabazuar (Vendimi E. nr. 2907/2011, i 5 marsit 2012).
15. Kësisoj, më 20 mars 2012, parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan, e cila hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar si dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale, të 5 marsit 2012 (Vendimi E. nr. 2907/2011).
16. Më 4 maj 2012, Gjykata Komunale në Gjiilan njoftoi parashtruesin se përmbarimi i vendimit ishte në fuqi, si dhe përmbarimi do të bëhej më 4 qershor 2012.
17. Më 31 maj 2012, parashtruesi dorëzoi një propozim për shtyrjen e përmbarimit në Gjykatën Komunale në Gjiilan. Gjykata Komunale në Gjiilan hodhi poshtë propozimin për shtyrje si të pabazuar (Vendimi E. nr. 2907/2011, i datës 4 qershor 2012).
18. Më 8 qershor 2012, parashtruesi u ankua ndaj aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan, e cila hodhi poshtë ankesën si të pabazuar (Aktvendimi Ac. nr. 222/2012, i datës 19 shtator 2012).
19. Parashtruesi pohon se, më 11 qershor 2012, Gjykata Komunale e përmbaroi vendimin e Gjykatës Komunale dhe largoi parashtruesin nga lokali afarist që e kishte marrë me qira. Nuk ka prova në shkresat e rastit që vërtetojnë këtë pohim të parashtruesit.

20. Më 10 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Prokurorit të Shtetit. Prokurori i Shtetit hodhi poshtë këtë kërkesë, sepse nuk gjeti asnjë bazë në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë (Njoftimi KMLC., nr. 106/2012, i datës 23 tetor 2012).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi pohon se ai *“[...] është larguar në mënyrë të dhunshme nga organi përmbarues i Gjykatës Komunale në Gjilan, nga lokali afarist të cilin ai e ka shfrytëzuar në bazë të kontratës së datës 4 shkurt 2009, dhe atë pa u zhvilluar asnjë procedurë gjyqësore”*.
22. Në këtë kuptim, parashtruesi i kërkon Gjykatës Kushtetuese *“[...] që të anulojë të gjitha vendimet e procedurës përmbarimore të Gjykatës Komunale në Gjilan dhe të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe të urdhërohet Gjykata Komunale në Gjilan që t’ia lejojë shfrytëzimin me qira të lokalit afarist në bazë të të drejtave dhe të obligimeve nga kontrata e datës 04.02.2009”*.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar me tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113.1, që përcakton se *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
25. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili parashikon: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”*.
26. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36.1 (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton që *“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar”*.
27. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet në fakte apo në ligje (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe deri në masën që gabimet e tilla të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, kjo gjykatë nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur trajton vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

28. Me fjalë të tjera, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në plotësinë e tyre, janë zhvilluar ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih, ndër dokumente të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991*).
29. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se parashtruesi nuk ka mbështetur me prova pretendimin e tij në baza kushtetuese, si dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga gjykatat e rregullta.
30. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009*).
31. Gjykata më tutje thekson se parashtruesi nuk ka iniciuar ndonjë procedurë ndaj Xh. K., përkitazi me të drejtat dhe me obligimet e tij sipas kontratës. Gjykata Komunale në Gjilan dhe Gjykata e Qarkut në Gjilan vetëm se kanë përcaktuar të drejtën e pronësisë ndërmjet Xh. K. dhe Z. Y.
32. Në përgjithësi, parashtruesi nuk ka treguar pse dhe si i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Vetëm renditja e disa dispozitave kushtetuese nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Kësisoj, nga parashtruesi i kërkesës nuk është parashtruar çështja në mënyrë ligjore në Gjykatë, prandaj, në bazë të rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës; në bazë të nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe në bazë të rregullit 36.1 (c) dhe 56.2 të Rregullores së punës, më 23 maj 2013 njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. TA SHPALL se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani